



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:082912

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05475108

P.nr.58/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE-DEGA KLINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, sipas Gjyqtares se vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në lëndën penale kundër të pandehurit E (M) P, nga fsh. B. K. R, e akuzuar për vepër penale, Ngacmimi nga neni 182 par. 4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje - Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II Nr.575/2023 të datës 31.03.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, dhe të pandehurës E. P me dt. 28.02.2024, vendosi dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20 Mars 2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurës E P, e lindur me dt. 07.05.1986 në fsh. B. K. R ku dhe tani banon, e bija e M dhe nenës D e vajzërisë M, pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, me profesion amvise, e identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., e nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Për shkak se:

Me dt..... rreth orës, në fshatin S. K, me dashje komunikon me qellim të ngacmimit dhe shqetësimit të dëmtuarit V. G në atë mënyre që e pandehura në vazhdimësi e thirrë përmes telefonit ku i thotë se “motra juaj që është e fejuar në Gjakovë nuk mund të vazhdojë këtë fejesë, sepse e njëjta është në lidhje dashurie me djalin tim Durimin dhe

duhet të prishet kjo fejesë”, me qëllim që të prishet fejesa e motrës së tij, po ashtu e pandehura i shkruan mesazhe të ndryshme në rrjetet sociale të dëmtuarit V me tekst me përmbajtje ngacmuese, shqetësuese si “burri im është duke u munduar të gjejë të fejuarin e motrës dhe do të ketë probleme me të”, ku me keto veprime e pandehura e vë në shqetësim të madh emocional të dëmtuarin.

-me çka ka kryer veprën penale “Ngacmimi” nga neni 182 par.4 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

GJYKON ME DËNIM ME KUSHT

Ashtu që:

1. Të akuzuarës E.P, e dënon më dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale

II. Dënimi me kushte do të revokohet konform nenit 50 të KPRK-së, nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese.

III. LIROHET: e pandehura nga shpenzimet e paushallit gjyqësor për shkak të gjendjes së dobët ekonomike.

IV. Udhëzohet: Pala e dëmtuar V. G nga fsh. S. K. K, që kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Peje – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngrit aktakuzën PP/II nr.575/2023 të datës 31.03.2023 kundër të pandehurës E. P, nga fsh. B.K. R, e akuzuar për vepër penale Ngacmim nga neni 182 par.4 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti i Përgjithshëm ashtu që pas administrimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit. Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore, vërtetoi se kompetente është kjo gjykatë.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 28.02.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit, të pandehurës E. P, ndërsa i dëmtuari edhe pse i është bërë ftesa nuk ka prezantuar në seancë .

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, e pandehura E . P, pasi e kuptoi, aktakuzën, është deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë. E pandehura ka deklaruar se i vjen keq për veprën e kryer, kam qenë në depresion në ato momente dhe është e vërtetë që e kam kryer veprën, mirëpo nga ajo ditë e gjerë me sot pothuajse ka kaluar një vit e nuk kemi patur probleme më. I premtoj gjykatës se nuk do të kryej më veprë penale të tillë apo të ngjashme, po ashtu është hera e par që kam rënë ndesh me ligjin.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurës, i njëjti është bërë në mënyrë të plot konform dispozitave ligjore, pasi i pandehuri e pranon fajësinë, e ky pranim fajësie gjen mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. I propozoi gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë, dhe kërkoj nga gjykata që të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoj se e pandehura ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 1 të KPPRK-se, janë përmbushur.

Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës. Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit konform nenit 242 të KPPRK-se.

E pandehura e ka deponuar në gjykatë se është familjare e viktimave të luftës, e lëshuar me dt. 18.07.2008 ku e drejta në pension ju është caktuar, dhe jetojnë nga të ardhurat e pensionit prej 130 €.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, "Ngacmimi" nga neni 182 par.4 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se e pandehura ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar e për më tepër ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, rrethanat personale të të akuzuarit pasi që njëjta është e pa punë dhe e gjendjes së dobët ekonomiko sociale, si dhe që i njëjti është shfrytëzuese e skemes sociale. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese Gjkata gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale.

Gjkata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 452 par. 4 të KPRK-së, gjykata ka liruar nga pagimin e paushallit gjyqësor.

ndikoj që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Kërkesa pasurore Juridike dhe shpenzimet e procedurës penale.

Konform nenit 462 par. 2 i KPRK-së, i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
Departamenti i Përgjithshëm Penal
P.nr.58/2023 me datë 20.03.2024

Zyrtare Ligjore
Liridona Palushi

Gjyqtarja gjykuese
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.